



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjuhësi**

Lënda: MORFOLOGJI E GJUHËS SHQIPE

Degët: Gjermanisht, Frëngjisht, Turqisht, Greqisht

<i>Pedagogu:</i>	Prof. as. Lindita XHANARI
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (20 leksione/ 20 seminare)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	I/I

Përshkrimi:

Kjo lëndë synon t'u japë studentëve njohuri praktike në lidhje me strukturën e fjalës në gjuhën shqipe, në lidhje me fjalëformimin në gjuhën shqipe, si dhe t'i njohë ata me pjesët e ligjëratës dhe kategoritë e tyre leksiko-gramatikore. Gjithashtu kursi synon t'i aftësojë studentët me njohuri praktike që kanë lidhje jo vetëm me analizën morfologjike të fjalës, por edhe me çështje të drejtshkrimit të fjalëve në gjuhën shqipe.

Në fund të kursit studentët duhet të jenë të aftë:

- Të bëjnë analizën morfemore dhe fjalëformuese të fjalës.
- Të diktojnë tipin fjalëformues.
- Të gjejnë pjesët e ligjëratës.
- Të gjejnë kategoritë gramatikore të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës.
- Të bëjnë klasifikime në grupe dhe nëngrupe të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës.
- Të mos bëjnë gabime sa i takon normës drejtshkrimore morfologjike.

Temat e leksioneve:



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I GJUHËS



1. Objekti i morfologjisë. Lidhjet e morfologjisë me sintaksën dhe fonetikën. Kriteret e klasifikimit të fjalëve në pjesë ligjërate.

2. Struktura e fjalës në gjuhën shqipe. Morfema dhe lidhjet e saj me fonemën e fjalën. Alomorfet dhe kushtet që duhet të plotësojnë morfet për të qenë alomorfe. Llojet e morfemave: morfemat rrënjore dhe morfemat ndajshitesore. Si bëhet identifikimi i morfemave.

3. Tema dhe llojet e saj. Analiza morfemore dhe analiza fjalëformuese. Mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe.

4. Emri dhe veçoritë e tij leksiko gramatikore. Emrat konkretë dhe abstraktë, të përgjithshëm dhe të përveçëm. Veçoritë e emrave përmbledhës dhe të lëndës. Kategoritë gramatikore të emrit dhe përmbajtja e tyre.

5. Kategoritë gramatikore. Gjinia e emrit. Numri i emrit. Mënyrat e shprehjes së shumësit të emrave. Mjetet dhe mënyrat e shprehjes së shumësit të emrave të gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane. Rasa e emrit. Lakimi, kriteret e klasifikimit të emrave në lakime. Veçoritë e lakimit të emrave në gjuhën e sotme letrare.

6. Shquarsia dhe pashquarsia. Shquarsia leksikore dhe gramatikore. Mjetet e shprehjes së shquarsisë. Mbaresat e shquarsisë dhe të ashtuquajturat nyje të përparme.

7. Mbiemri dhe veçoritë e tij kuptimore dhe gramatikore. Kuptimi kategorial i mbiemrave, lidhja kuptimore me pjesë të tjera të ligjëratës. Klasifikimi sipas kuptimit leksikor. Klasifikimi gramatikor i mbiemrave. Kategoritë gramatikore të mbiemrit. Kategoria e gjinisë dhe e numrit. Shkallët e mbiemrit. Emërzimi i mbiemrit.

8. Përemri. Llojet e përemrave dhe klasifikimi i tyre sipas kuptimit dhe shërbimit që ato kryejnë. Përemrat-emra, përemrat-mbiemra dhe përemrat-numërorë. Përemri dëftor. Kategoritë gramatikore të përemrit dëftor. Përemri vetor. Kategoritë gramatikore të përemrit vetor. Veçoritë e lakimit të përemrit vetor. Trajtat e shkurtra dhe trajtat e bashkuara, veçoritë e tyre.

9. Përemri pronor. Si ndryshon gjinia tek përemrat pronorë. Veçoritë e lakimit të përemrit pronor. Emërzimi i tij. Përemri lidhor. Veçoritë kuptimore dhe gramatikore. Kuptimi dhe funksioni i përemrave lidhorë. Përemrat pyetës, veçoritë kuptimore dhe gramatikore. Përemrat e pacaktuar, veçoritë kuptimore dhe gramatikore. Klasifikimi i tyre.

10. Folja, veçoritë kuptimore dhe gramatikore. Klasifikimi i foljeve: ndihmëse dhe gjysmëndihmëse. Kategoritë gramatikore të foljes. Kategoria e vetës, kuptimi i vetës tek folja, ndryshimi nga veta e përemrave. Kategoria e numrit. Kuptimi i numrit tek folja, ndryshimi nga numri i pjesëve të tjera të ligjëratës. Kategoria e diatezës. Klasifikimi i foljeve në diateza. Kategoria e mënyrës. Modaliteti dhe kategoria gramatikore e mënyrës. Grupimet e foljeve në mënyra.

11. Kategoria e kohës. Koha dhe aspekti. Klasifikimi i foljeve në zgjedhime. Format e shtjella dhe të pashtjella. Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës dëftore (zgjedhimi vepror dhe jovepror). Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës lidhore (zgjedhimi vepror dhe jovepror). Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës habitore (zgjedhimi vepror dhe jovepror).



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I GJUHËS



12. Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës kushtore (zgjedhimi vepror dhe jovepror). Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës dëshirore (zgjedhimi vepror dhe jovepror). Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës urdhërore.

Pjesorja dhe format e pashtjelluara të ndërtuara mbi bazën e saj.

13. Ndajfolja. Ndajfoljet përemërore dhe veçoritë e tyre. Klasifikimi i ndajfoljeve. Ndajfoljet e mënyrës, sasisë, kohës, vendit, shkakut dhe veçoritë e tyre. Kategoria e shkallës të ndajfolja. Lidhëzat, klasifikimi i tyre sipas funksionit sintaksor dhe sipas strukturës morfologjike. Lidhëzat bashkërenditëse dhe lidhëzat nënrenditëse, llojet dhe veçoritë e tyre.

14. Parafjalët. Klasifikimi i tyre sipas rasave, prejardhjes dhe sipas strukturës morfologjike. Pjesëzat, vendi i tyre në fjali. Klasifikimi i tyre sipas strukturës. Pashirrat dhe veçoritë e tyre.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve

- Angazhimi në seminare:

20% e notës

- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):

-

- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim

80% e notës

- Gjithsej:

100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1 *Gramatika e gjuhës shqipe, V.I*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.

2. Latifi, L., *Tekst ushtrimesh (Morfologji e gjuhës shqipe)*, Tiranë, 2010.

Literatura plotësuese:

1 *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, V. I,II*, Akademia e Shkencave, 1976.